

Nr. 294 Prot
Dt: 21.03.2017



- LV/KERKONDORE ✓
- Dekretet
- Prop. të detyrës të shpallur
21.03.2017
(MULLI)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 294 Prot.

Tiranë, më 20.03.2017

URDHËR

Nr. 126, datë 20.03.2017

PËR

**HAPJEN E NJËSISË KRYESORE "FAKULTETI EKONOMIK", TË
UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 30, pika 5 ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e njësisë kryesore "Fakulteti Ekonomik", të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, me strukturën si më poshtë:
 - a) Departamenti Kontabilitet-Financë;
 - b) Departamenti Administrim Publik;
 - c) Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit.
2. Veprimtaria akademike për njësinë kryesore "Fakulteti Ekonomik", fillon në vitin akademik 2017-2018.
3. Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Shpenzimet financiare për hapjen e fakultetit të ri të mbulojnë sipas vendimmarrjes së Bordit të Administrimit të këtij Universiteti.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë dhe Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

ELINDITA NIKOLLA

MINISTËR



Adresa: "Rruga e Durrësit", AL 1001, Tiranë
Tel: +355 4 222 22 60

Web site: www.arsimi.gov.al